

Salus Tirana Sha

**Pasqyrat Financiare
per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014**

Përmbajtja:

Raporti i audituesit të pavarur.....	4
Pasqyrat Financiare në 31 dhjetor 2014.....	5
Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2014.....	7
Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin që mbyllet me 31 dhjetor 2014.....	8
Pasqyra e flukseve monetare për vitin që mbyllet me 31 dhjetor 2014.....	9
1. Informacion i përgjithshëm.....	10
2. Bazat e përgatitjes.....	12
3. Politikat kontabël.....	13
3. Politikat kontabël (vazhdim).....	15
3. Politikat kontabël (vazhdim).....	17
4. Përmbledhje politikave kryesore kontabël.....	18
5. Përdorimi i vlerësimeve dhe i gjykimeve.....	18
6. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre.....	21
7. Llogarite e arkëtueshme.....	22
8. Llogarite e arkëtueshme tregtare dhe të tjera.....	22
9. Tatim fitimi i parapaguar.....	22
10. Inventari.....	23
11. Shpenzime të shtyra.....	23
12. Aktivët afatgjatë materiale.....	24
13. Aktivët afatgjatë jomateriale.....	25
14. Furnitorë dhe llogari të tjera të pagueshme.....	26
15. Huamarrje afatshkurtra.....	26
16. Huamarrje afatgjatë.....	26
17. Kapitali.....	27
18. Të ardhurat.....	27
19. Kosto e materialeve.....	28
20. Shpenzime personeli.....	28
21. Shpenzime të tjera.....	28
22. Fitim/Humbjet nga këmbimet valutore.....	29
23. Shpenzim interesi.....	30

24. Shpenzim tatim fitimi.....	30
Rakordimi i normës efektive të tatimit është paraqitur në tabelën më poshtë.....	30
25. Palët e lidhura.....	31
26. Angazhime dhe pasiguri.....	31
27. Risku financiar.....	32
28. Ngjarje pas datës së bilancit.....	32

Salus Tirana sh.a
Bilanci kontabel per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014
(Shumat ne Lek)

	Shenime	31 Dhjetor 2014	31Dhjetor 2013
Aktivët			
I. Aktivët afatshkurtra			
Mjete monetare	6	7,894,064	35,553,075
Llogari te arketueshme	7	16,409,362	15,480,033
TVSH e arketueshme		2,540,674	56,933,233
Tatim fitimi	9	127,000	127,000
Parapagime		733,166	1,211,685
Shpenzime te shtyra	11	153,773,509	113,215,084
		181,477,774	222,520,111
Inventar	10	21,318,640	19,409,870
Total i aktiveve afatshkurtra (I)		202,796,414	241,929,981
II. Aktivët afatgjata			
Toka		122,531,950	122,531,950
Ndertesë		1,181,748,400	1,186,616,665
Makineri dhe paisje		342,512,752	344,980,477
Mjete transporti		4,798,849	5,258,958
Mobilje dhe orendi		52,010,249	58,505,252
Paisje informatike		4,401,173	6,892,210
Te tjera aktive		4,271,488	3,622,748
Aktive ne proces	12	-	-
Aktive afatgjata jo materiale	13	17,080,457	18,294,576
Totali i aktiveve afatgjata (II)		1,729,355,317	1,746,702,836
Totali i aktiveve (I + II)		1,932,151,732	1,988,632,817
Detyrimet dhe kapitali			
I. Detyrimet afatshkurtra			
Llogari te pagueshme	14	150,531,999	93,644,248
Te pagueshme ndaj personelit		9,420,073	10,715,117
Detyrime tatimore		4,221,637	3,570,318
Te tjera detyrime		-	-
Shpenzime te llogaritura		0	4,145,094
Hua afatshkurtra	15	189,745,019	51,840,878
Overdraft		80,172,669	31,907,353
Totali i detyrimeve afatshkurtra (I)		434,091,397	195,823,008
II. Detyrimet afatgjata			
Hua bankare	16	460,899,780	622,600,978
Totali i detyrimeve afatgjata (II)		460,899,780	622,600,978
Totali i detyrimeve (I + II)		894,991,176	818,423,985
III. Kapitali			
Kapitali i shoqerise		1,609,562,000	1,609,562,000
Humbje te mbartura		(439,353,169)	(209,909,469)
Humbje periudhe	24	(133,048,277)	(229,443,700)
Totali i kapitalit (III)		1,037,160,554	1,170,208,831
Totali i detyrimeve dhe kapitalit (I,II,III)		1,932,151,732	1,988,632,817

Salus Tirana sh.a

Bilanci kontabel per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

(Shumat ne Lek)

Bilanci duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 9 deri 32 që janë pjesë përbërëse të pasqyrave financiare

Salus Tirana sh.a**Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014***(Shumat ne Lek)*

	Shenime	Per periudhen nga 1 janar 2014 deri me 31 dhjetor 2014	Per periudhen nga 1 janar 2013 deri me 31 dhjetor 2013
Te ardhurat nga aktiviteti			
Te ardhurat nga shitja e mallrave	18	373,620,591	202,668,420
Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit		<u>1,765,760</u>	<u>6,080,724</u>
		<u>375,386,350</u>	<u>208,749,144</u>
Shpenzimet operative			
Materiale te konsumuara	19	(71,305,583)	(64,014,758)
Shpenzime personeli	20		
-pagat e personelit		(149,637,073)	(149,553,666)
-kontributet per sigurimet shoqerore dhe shendetesore		(13,995,747)	(9,544,991)
Amortizimi dhe zhvleresimi	12	(72,538,955)	(69,011,545)
Shpenzim/rimarrje provizione		-	-
Shpenzime te tjera	21	(151,803,512)	(96,306,760)
		<u>(459,280,870)</u>	<u>(388,431,719)</u>
Totali i shpenzimeve		<u>(459,280,870)</u>	<u>(388,431,719)</u>
Fitimi nga veprimtaria kryesore		<u>(83,894,520)</u>	<u>(179,682,575)</u>
Te ardhura/shpenzime nga interesa	23	(49,078,726)	(46,941,136)
Te ardhura/shpenzime nga kursi kembimi	22	<u>(75,031)</u>	<u>(2,819,989)</u>
Totali i te ardhurave financiare - neto		<u>(49,153,757)</u>	<u>(49,761,125)</u>
Fitimi para tatimit		(133,048,277)	(229,443,700)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	24		
Fitimi i periudhes		<u>(133,048,277)</u>	<u>(229,443,700)</u>

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 9 deri 32 që janë pjesë përbërëse të pasqyrave financiare.

Salus Tirana sh.a**Pasqyra e ndryshimeve ne kapital per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014***(Shumat ne Lek)*

	Kapitali	Rezerva	Fitim/humbje te akumuluar	Totali
Gjendja me 01.01.2014	1,609,562,000		(439,353,169)	1,170,208,831
Dividente te paguar				
Diferenca nga konvertimi	-		-	-
Humbja neto			(133,048,277)	(133,048,277)
Gjendja me 01.01.2014	1,609,562,000		(572,401,446)	1,037,160,554

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 9 deri 32 qe jane pjesë përbërëse të pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare u aprovuan nga Bordi Drejtues ne ___ Mars 2015.

Ilda Duhaxhiu

Specialiste, Kontabiliteti



Sidney Stock

Administrator



Salus Tirana sh.a
Pasqyra e flukseve monetare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014
(Shumat ne Lek)

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
I. Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit		
Fitimi i periudhes	(133,048,277)	(229,443,700)
Rregullime per:		
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		
Amortizimi	72,538,955	69,011,545
Provizione		
Shpenzime per interesa	49,078,726	46,941,136
Humbje nga kembimi te perealizuara	(555,607)	2,819,989
Fitimi operativ para ndryshimeve ne kapitalin punues	(11,986,203)	(110,671,030)
Rritje(zvogelim) ne llogarite e arketueshme	(929,328)	(15,133,000)
Rritje(zvogelim) ne llogarite e tjera te arketueshme	(40,079,906)	194,826,324
Rritje(zvogelim) nga inventari	(1,908,770)	(4,493,059)
Rritje ne llogari te pagueshme	56,887,750	(37,421,392)
Rritje ne detyrime te tjera	(1,518,930)	(21,927,468)
Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit	0	0
Interesi i paguar	(43,490,789)	(42,951,812)
Tatim fitimi i paguar		
Fluksi neto monetar perdorur ne veprimtarite e shfrytezimit	(43,026,176)	(37,771,438)
II. Fluksi monetar nga veprimtarite e investimit		
Bjerje e aktiveve afatgjata materiale	(21,338,375)	(31,493,397)
Shitje aktiveve afatgjata materiale	11,787,651	27,220,032
Blerje e aktiveve afatgjata jomateriale	(420,150)	(1,190,326)
Shitje aktiveve afatgjata jomateriale	869,778	3,158,386
Fluksi neto monetar perdorur ne veprimtarite e investimit	(9,101,096)	(2,305,844)
III. Fluksi monetar nga veprimtarite e financimit		
Te ardhura nga emetimi i kapitalit aksionar		
Zvogelim nga huamarrje afatgjate	(219,724,343)	(28,445,342)
Rritje nga huamarrje afatgjate	244,192,603	56,080,000
Fluksi neto monetar nga veprimtarite e financimit	24,468,260	27,634,658
IV. Rritja/(pakesimi) neto i mjeteve monetare	(27,659,011)	(12,442,623)
V. Mjetet monetare ne fillim te periudhes	35,553,076	47,995,699
VI. Mjetet monetare ne fund te periudhes	7,894,064	35,553,076

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 9 deri 32 që janë pjesë përbërëse të pasyrave financiare.

Salus Tirana sh.a

Shenimet shpjeguese per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

(Shumat ne Lek)

1. Informacion i përgjithshëm

Salus Tirana Sh.a (Shoqëria) është themeluar në 22 Tetor 2008 si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me ligjin numër 7638 datë 14.04.2008 “Mbi shoqëritë tregtare” me ligjin numër 9723 datë 3.5.2007 “Mbi Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Aktiviteti kryesor i Kompanisë është ofrimi shërbimeve jo publike mjekësore dhe spitalore.

Struktura e kapitalit të aksioneve të shoqërisë është si më poshtë:

- Anastas Pecini me 16.24%
- Olti Pecini me 23.76%
- Salus Holding me 34.77%
- Policlinico Triestino me 11.97%
- Finest me 9.77%
- Acane Investment Corporation me 3.50%

Anëtarë të Këshillit Drejtues të Kompanisë janë Z.Guglielmo Danelon, Z.Franco Stock, Z.Olti Pecini dhe Z. Anastas Pecini regjistruar sipas çertifikatës së Qendrës Kombëtare të Regjistrimit datë 20.01.2012.

Përfaqësuesit Ligjore të Salus Tirana sh.a. janë Z.Sidney Stock dhe Z. Rition Margariti.

2. Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), mbi bazën e metodës së kostos historike.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur bazuar në parimin e vijimësisë, i cili supozon se Shoqëria do të vazhdojë të veprojë dhe në periudhat në vazhdim.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtuesit të bëjnë vlerësime dhe supozime. Bordi drejtues ushtron gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë. Elementët e pasqyrave financiare që kërkojnë një nivel më të lartë gjykimi ose subjektiviteti dhe për të cilat supozimet dhe gjykimet kanë influencë më të lartë janë shpjeguar në shënimin shpjegues 4.

3. Standardet e reja dhe interpretimet

3.1. Standardet të reja dhe të ndryshuara të zbatuara nga Shoqëria

(i) Standardet të reja dhe të ndryshuara të zbatuara nga Shoqëria

Nuk ka SNRF apo interpretime të reja të Komiteti Ndërkombëtar i Interpretimeve për Raportimin Financiar (KNIRF) të cilat hyjnë në fuqi për herë të parë gjatë vitin financiar që fillon më ose pas datës 1 janar 2012 dhe që kanë një ndikim të rëndësishëm ndaj Shoqërisë.

3. Standardet e reja dhe interpretimet (vazhdim)

3.1 Standardet të reja dhe të ndryshuara të zbatuara nga Shoqëria (vazhdim)

(ii) Disa standarde dhe interpretime të reja janë publikuar dhe janë të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013 të cilat Shoqëria nuk i ka adoptuar më herët

SNRF 9, “Instrumentet financiare: klasifikimi dhe matja”. SNRF 9, i publikuar në nëntor të vitit 2009, zëvendëson ato pjesë të SNK 39 që lidhen me klasifikimin dhe matjen e instrumenteve financiare. SNRF 9 u ndryshua më tej në tetor 2010 për të përcaktuar klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare dhe në Dhjetor 2011 (i) për të ndryshuar datën efektive në periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2015 dhe (ii) për të përfshirë shënime shpjeguese për periudhën e tranzicionit.

Karakteristikat kryesore të standardit janë si më poshtë:

Aktivitetet financiare duhet të klasifikohen në dy kategori matjeje: në aktive financiare të cilat do të maten në periudhat e mëpasshme me vlerë të drejtë, dhe ato të cilat do të maten në periudhat e mëpasshme me kosto të amortizuara. Vendimi duhet të merret në momentin e njohjes fillestare të aktivitetit. Klasifikimi varet nga modeli që njësia ekonomike ndjek për menaxhimin e aktiveve të veta financiare dhe karakteristikat kontraktuale të flukseve monetare të instrumentit.

Një instrument matet në periudhat e mëpasshme me kosto të amortizuara vetëm nëse është një instrument borxhi dhe dy kushtet në vijim plotësohen njëkohësisht: (i) objektivi i njësies ekonomike është të mbajë aktivin për të përfituar flukset monetare kontraktuale, dhe (ii) flukset monetare kontraktuale të aktivitetit përfaqësojnë vetëm pagesa principali dhe interesi (që do të thotë që instrumenti ka vetëm “karakteristikat bazë të huasë”). Të gjithë instrumentet e tjerë të borxhit duhet të maten me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimeve ose humbjeve.

Të gjithë instrumentet e kapitalit duhet të vlerësohen në periudhat e mëpasshme me vlerë të drejtë. Instrumentet e kapitalit të cilat mbahen për tregtim do të maten me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimeve ose humbjeve. Për të gjithë instrumentet e tjerë të kapitalit, në momentin e njohjes fillestare mund të bëhet një zgjedhje e pakthyeshme për të njohur fitimet dhe humbjet kapitale të realizuara dhe të përcaktuara përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe jo përmes pasqyrës fitimeve ose humbjeve. Fitimet ose humbjet nga vlera e drejtë nuk do të kalojnë më përmes fitimeve ose humbjeve. Kjo zgjedhje mund të bëhet veçmas për çdo instrument. Dividendët duhet të prezantohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, për sa kohë ata përfaqësojnë kthime nga investimi.

Pjesa më e madhe e kërkesave të SNK 39 për klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare janë transferuar pa ndryshime tek SNRF 9. Ndryshimi kryesor është se njësies ekonomike tashmë do i kërkohet të paraqesë efektet e ndryshimeve në rrezikun kreditor të detyrimeve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitimeve ose humbjeve në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

Ndërkohë që zbatimi i SNRF 9 është i detyrueshëm prej datës 1 Janar 2015, zbatim më i hershëm është i lejueshëm.

SNFR 13, “Matja e vlerës së drejtë” (publikuar në Maj të vitit 2011 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2013), ka për qëllim të përmirësojë konsistencën dhe të reduktojë kompleksitetin duke ofruar një përkufizim të rishikuar të vlerës së drejtë, një burim të vetëm për matjen e vlerës së drejtë, si dhe kërkesat për dhënien e shënimeve shpjeguese për përdorim nga gjithë SNRF-të.

Ndryshimet në SNK 1, “Paraqitja e pasqyrave financiare” (publikuar në qershor 2011 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 korrik 2012) ndryshojnë mënyrën e paraqitjes së shënimeve shpjeguese të zërave të përfshira në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Ndryshimet kërkojnë që njësia ekonomike të paraqesë zërat e paraqitur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse në dy grupe, në varësi të faktit nëse ekziston ose jo mundësia e ri-klasifikimit të tyre në fitim ose humbje në të ardhmen. Emërtimi i sugjeruar nga SNK 1 është ndryshuar në “pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse”. Shoqëria pret që standardi i ndryshuar të ndikojë në paraqitjen e pasqyrave të saj financiare, por duke mos ndikuar në matjen e transaksioneve dhe balancave.

Ndryshime në SNRF 7, “Shënime shpjeguese – Kompensimi i aktiveve dhe pasiveve financiare” (publikuar në dhjetor 2011 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2013). Ndryshimi kërkon dhënie të shënimeve shpjeguese në pasqyrat financiare të cilat mundësojnë vlerësim të efektit apo efektin e mundshëm të marrëveshjeve të kompensimit nga lexuesi i pasqyrave, duke përfshirë edhe të drejtat për kompensim.

Ndryshime në SNK 32, “Kompensimi i aktiveve dhe pasiveve financiare” (publikuar në dhjetor 2011 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose më pas datës 1 janar 2014). Ndryshimi ka sjellë udhëzime shtesë për zbatimin e SNK 32 për të mënjeluar mungesën e konsistencës lidhur me zbatimin e disa prej kritereve të kompensimit.

Këtu përfshihet edhe sqarimi e kuptimit të shprehjes “e drejtë ligjore e detyrueshme për të kompensuar” dhe që disa sisteme të kompensimit në baza bruto mund të konsiderohen ekuivalente me ato të kompensimit neto.

3. Standardet e reja dhe interpretimet (vazhdim)

3.1 Standardet të reja dhe të ndryshuara të zbatuara nga Shoqëria (vazhdim)

Përmirësime të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (publikuar në Maj 2012 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2013). Përmirësimet konsistojnë në ndryshime të pesë standardeve. SNRF 1 u ndryshua (i) për të qartësuar se një njësi ekonomike që rinis të përgatisë pasqyrat e saj financiare duke u bazuar në SNRF mund të ri-aplikojë SNRF 1 ose të aplikojë të gjitha SNRF-të retrospektivisht sikur të mos kishte ndaluar ndonjëherë së aplikuari ato, dhe (ii) për të shtuar një përjashtim nga aplikimi retrospektiv i SNK 23 “Kosto të huamarrjes” nga zbatuesit për herë të parë të SNRF-ve.

SNK 1 u ndryshua për të qartësuar se shënime shpjeguese nuk nevojiten për të mbështetur bilancin e tretë të paraqitur në fillim të periudhës pasardhëse e cila mund paraqitet për shkak të ndikimit të rëndësishëm të ri-paraqitjes retrospektive, ndryshimeve në politikat kontabël apo ri-klasifikimeve për qëllime të paraqitjes, ndërkohë që dhënia e shënimeve shpjeguese do të jetë e nevojshme vetëm nëse Shoqëria vendos që të ofroje pasqyra krahasuese shtesë vullnetarisht. SNK 16 u ndryshua për të qartësuar se pajisjet e shërbimit të cilat do të përdoren për më shumë se një periudhe do të klasifikohen si aktive afatgjata materiale dhe jo si inventar. SNK 32 u ndryshua për të qartësuar se pasojat tatimore të shpërndarjeve ndaj aksionarëve duhet të kontabilizohen në pasqyrën e të ardhurave, siç janë kërkuar gjithmonë nga SNK 12. SNK 34 u ndryshua për të mundësuar përputhjen e kërkesave të saj me ato të SNRF 8. SNK 34 do të kërkojë dhënien e shënimeve shpjeguese për një tregues të matjes së totalit të aktiveve dhe pasiveve për një segment operativ të caktuar, vetëm nëse ky informacion i jepet rregullisht vendimmarrësit të aktivitetit operativ dhe ka patur një ndryshim të rëndësishëm në këto tregues nga pasqyrat financiare të vitit të kaluar.

Standarde dhe interpretime të tjera të rishikuara të cilat nuk janë relevante për Shoqërinë:

- SNRF 10 “Pasqyrat financiare të konsoliduara”
- SNRF 11, “Marrëveshjet e përbashkëta”
- SNRF 12, “Shënime shpjeguese mbi interesat në njësi të tjera ekonomike”
- SNK 27, “Pasqyrat financiare individuale”
- SNK 28, “Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta”
- SNRF 1 “Zbatimi i SNRF-ve për herë të parë – Huatë qeveritare”
- SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27 – “Njësitë ekonomike investuese”
- SNK 19 i ndryshuar, “Përfitimet e punonjësve”
- KIRFN 20, “Shpenzimet e nxjerrjes në procesin e prodhimit të një mine sipërfaqësore”

Standardet dhe interpretimet e reja nuk pritet të kenë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë, nëse nuk është përmendur ndryshe më sipër.

Politikat kryesore kontabël të aplikuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë aplikuar në mënyrë konstante në të gjitha periudhat e paraqitura, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe.

4. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël

Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë si me poshtë. Këto politika janë zbatuar në të gjitha vitet e paraqitura, nëse nuk specifikohet ndryshe.

4.1. Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), mbi bazën e metodës së kostos historike.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur bazuar në parimin e vijimësisë, i cili supozon se Shoqëria do të vazhdojë të veprojë dhe në periudhat në vazhdim.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtuesit të bëjnë vlerësime dhe supozime. Bordi drejtues ushtron gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë. Elementët e pasqyrave financiare që kërkojnë një nivel më të lartë gjykimi ose subjektiviteti dhe për të cilat supozimet dhe gjykimet kanë influencë më të lartë janë shpjeguar në shënimin shpjegues 4.

4.2. Paraqitja e pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

4.3. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale sipas kursit të këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivet dhe detyrimet monetare të regjistruara në monedha të huaja në datën e raportimit, konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së raportimit. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare të regjistruara në monedhë të huaj që matën me kosto të amortizuar, konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën kur kryhet transaksioni. Diferencat që vijnë nga këmbimet valutore njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

4.4. Njohja e të ardhurave

Politikat kontabël për njohjen e të ardhurave nga kontratat e sigurimit janë paraqitur në notën *(Njohja dhe matja e kontratave)*. Të ardhurat nga interesi për aktivet financiare është njohur duke përdorur metodën e interesit efektiv.

4.4.1. Të ardhura nga shitja e mallrave

Të ardhurat nga shitja e mallrave maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, neto nga TVSH, akcizat, kthimet, skontimet dhe zbritjet. Të ardhurat do të njihen kur rreziqet dhe përfitimet e rëndësishme të pronësisë janë transferuar tek blerësi, marrja e përfitimeve është e mundur, kostot e lidhura me kthimin e mundshëm të mallrave mund të vlerësohen me besueshmëri, nuk ka përfshirje të vazhdueshme të drejtimit tek mallrat dhe sasia e të ardhurave mund të matet me besueshmëri. Transferimi i rreziqeve dhe përfitimeve ndryshon në varësi të kushteve të kontratës së shitjes. Transferimi zakonisht ndodh kur produkti arrin në magazinën e klientit.

4.4.2 Pasqyrimi i shërbimeve

Te ardhurat vjetore nga shërbimet njihen duke iu referuar fazes së përmbushjes sipas dates se raportimit. Faza e perfundimit matet duke iu referuar shërbimeve te kryera deri më sot si perqindje e totalit te shërbimeve qe do të kryehen. Kur rezultati i kontratës nuk mund të matet me besueshmëri, te ardhurat vjetore njihen vetem deri në masën që shpenzimet e kryera jane te pranueshme, te pershtatshme per t'u mbuluar.

Tarifat e hyrjeve njihen si të ardhura kur bashkohen të gjitha kriteret për njohjen e të ardhurave vjetore nga kryerja e shërbimeve, por jo më herët se data e hapjes se rezerves respektive.

4. Përmbledhje e politikave kryesore kontabel

4.4.3. Të ardhura nga interesi

Të ardhurat nga interesat përbën interes për aktuale bankare dhe llogaritë e depozitave dhe të njihet në fitim ose humbje në baza kohore proporcion duke përdorur metodën e interesit efektiv.

4.4.4 Aktivet afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale mbahen me kosto historike duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka. Kosto historike përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejtë me koston e blerjes së aktivit. Kostot e mëpasshme përfshihen në vlerën kontabël të aktivit afatgjatë material ose njihen si aktiv më vehte vetëm nëse është e mundshme që Shoqëria të ketë përfitime të ardhshme ekonomike të lidhura me aktivin në fjalë dhe kostoja e tij të mund të matet në mënyrë të besueshme. Të gjithë shpenzimet e tjera të mirëmbajtjeve dhe riparimeve njihen në fitim/humbje në momentin që ato ndodhin. Shoqëria nuk ka në pronësi ndonjë truall apo ndërtesë.

Amortizimi llogaritet në mënyrë lineare për të shpërndarë koston e aktiveve afatgjata materiale përgjatë jetës së tyre të dobishme. Amortizimi fillon të njihet në muajin pas atij të blerjes. Jetët e dobishme të zbatuara janë si në vijim

Përshkrimi i kategorisë	Metoda	Përqindje/Vit
Ndërtesa	Lineare	2%
Instalimet teknike, makineri dhe pajisje	Lineare	8%
Mjete transporti	Lineare	10%
Pajisje zyre dhe mobilje	Lineare	10%
Kompjutera dhe pajisje zyre	Lineare	25%
Aktive të tjera	Lineare	10%

Jeta e dobishme dhe vlera e mbetur e aktivit rishikohet dhe rregullohet, nëse është e nevojshme, në çdo datë raportimi. Vlera kontabël e një aktivit zvogëlohet menjëherë deri në vlerën e tij të rikuperueshme nëse vlera e mbetur e tij tejkalon këtë vlerë.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale njihen në zërin 'Të ardhura të tjera operacionale' në fitim ose humbje.

4.6 Aktive afatgjata jomateriale

Aktivitet afatgjata jo materiale te blera nga Kompania te cilat te kane jetëgjatësi te përcaktuar maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Shpenzimet e mëpasshme

Shpenzimet e mëvonshme kapitalizohen vetëm kur rrit përfitimet e ardhshme ekonomike këtij aktivi për të cilin ai lidhet. Të gjitha shpenzimet tjera, përfshirë shpenzimet për emrin e mirë të prodhuar vetë dhe të markave, njihet në pasqyrën e të ardhurave kur ato ndodhin. Shpenzimet lidhur me mbajtjen e programeve softëare kompjuteri njihen si shpenzime në momentin kur ndodhin.

4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.6 Aktivitet jo-materiale (vazhdim)

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi bazë lineare përgjatë jetës së dobishme ekonomike të vlerësuar të aktiveve jo-materiale qe prej datës se vënies ne perdorim.

Kosto e programeve kompjuterike te njohura si aktiv amortizohen përgjatë jetës se dobishme te vlerësuar e cila nuk eshte me e madhe se katër vjet. Jeta e dobishme e aktivitet rishikohen dhe rregullohen nëse është e nevojshme, në fund të çdo viti financiar. Fitimet ose humbjet që rrjedhin nga çregjistrimi i një aktivi jo-material maten si diferencë midis të ardhurave neto nga nxjerrja jashtë përdorimi dhe vlera kontabël neto e aktivitet dhe njihen në fitim ose humbje.

4.7 Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata financiar dhe aktiveve afatgjata jo-financiare

Për të vlerësuar dëmtim kompania përcakton grupin më të vogël të identifikueshëm të aktiveve që gjenerojnë flukse hyrëse monetare (njësi gjeneruese e mjeteve monetare). Si rezultat disa prej aktiveve testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale dhe të tjera si një pasuri që i përkasin njësisë

gjeneruese të mjeteve monetare.

Në çdo datë raportimi, kompania vlerëson nëse ka indikacion se një njësi gjeneruese të mjeteve monetare mund të jetë zhvlerësuar. Të gjitha aktivet e tjera janë testuar për zhvlerësim nëse ngjarjet apo rrethanat kanë ndodhur që tregojnë vlerën kontabël të aktiveve nuk mund të mbulohen.

Kompania njih humbje nga zhvlerësimi, nëse vlera kontabël e një aktivi individual ose një njësi gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme të aktivitetit, e cila është më e lartë e vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Për të përcaktuar vlerën në përdorim kompania përgatit një vlerësim të flukseve monetare të ardhshme nga çdo njësi gjeneruese të mjeteve monetare dhe përdor një normë skontimi të përshtatshme për të llogaritur vlerën aktuale të këtyre flukseve të mjeteve monetare.

Të dhënat e përdorura në testet për zhvlerësim është i bazuar në buxhetin e aprovuar më të fundit të përshtatura për të eliminuar efektet e riorganizimit e ardhshme apo përmirësime të rëndësishme të aktiveve. Normat e skontimit janë të përcaktuara veçmas për çdo njësi gjeneruese të mjeteve monetare për të pasqyruar profilin e tyre specifike të rrezikut siç është vlerësuar nga ana e menaxhmentit të kompanisë. Humbja nga zhvlerësimi i një njësie gjeneruese të mjeteve monetare është e njohur si një rënie e vlerës kontabël të të gjitha pasurive në njësi.

Për aktivet gjitha kompanisë bëhet vlerësimi në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë tregues të njohur më parë humbjet nga zhvlerësimi mund të ekzistojnë ose mund të jenë zvogëluar. Një humbje nga zhvlerësimi e njohur më parë rimerret plotësisht ose pjesërisht, vetëm nëse shuma e rikuperueshme e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e tij kontabël, e cila ndryshim është i kufizuar në shumën e humbjeve nga zhvlerësimi që janë njohur në fitim ose humbje për të njëjtën të mjeteve monetare njësi gjeneruese. Një aktiv financiar vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna objektive për zhvlerësimin e tij. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

4.8. Qiratë

4.8.1 Qiratë, në të cilat një pjesë e rëndësishme e rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë mbahen nga qiradhënësi, klasifikohen si qira operative. Pagesat e bëra për qiratë operative njihen në fitim ose humbje me metodën lineare përgjatë jetës së qirasë. Nxitjet e marra për qiratë njihen si pjesë integrale e shpenzimeve totale të qirasë, përgjatë kohëzgjatës së qirasë.

4. Përmbledhje e politikave kryesore kontabel (vazhdim)

4.8. Qiratë (vazhdim)

4.8.2 Kompania si qiradhënëse

Subjekti i aseteve të kontratat me qera rrjedhese prezantohet ne permbledhjen e situates financiare te kompanise dhe zhvleresohet ne perputhje me politikat e zhvleresimit te pranuar nga kompania per asete te ngjashme. Te ardhurat e qerese nga qerate rrjedhese funksionale njihen si fitim ose humbje ne nje baze lineare pertej afatit te qerese.

Kompania njih asetet e mbajtura ne nje qera financiare ne paraqitjen e pozicionit financiar dhe i prezanton ato si te arketueshme ne nje shume te barabarte per investimin Neto ne qera. Te ardhurat

Neto nga shitjet e asetëve njihen si përfitime ose humbje për periudhën respektive. Njohja dhe vlerësimi i të ardhurave financiare duhet të bazohet në një model refektimi, renditje konstante periodike të kthimit të netos së qeradhenesit.

4.9. Inventarët

Inventarët maten me më të ultën midis kostos dhe vlerës së realizueshme neto. Kosto e inventarëve llogaritet me metodën FIFO (hyn i pari, del i pari), dhe përfshin të gjithë shpenzimet e ndodhura gjatë blerjes dhe kostot e tjera që nevojiten për ta sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese duke përfshirë koston e banderolave të blera nga Dogana Shqiptare në lidhje me akcizën e produktit.

Vlera e realizueshme neto është çmimi i vlerësuar i shitjes gjatë veprimtarisë normale të biznesit pakësuar me kostot e vlerësuara të përfundimit dhe shpenzimet e shitjes.

4.10. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare tyre përbëhen nga paraja në arkë, llogaritë rrjedhëse në banka dhe depozitat afatshkurtra të mbajtura në banka. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

4.11. Instrumentat financiarë

Instrumente financiare e kompanisë gjatë viteve 2012 përbëhej ekskluzivisht e instrumenteve jo-derivative financiare: huatë dhe të arkëtueshmet (tregtare dhe të tjera), para të gatshme dhe ekuivalentët e saj (të cilat përfshijnë depozitat bankare të mbajtura deri në maturim), dhe të tjera të pagueshme. Instrumentat financiar mbahen në vlerën e drejtë ose me koston e amortizuar të përshkruar më poshtë, në varësi të klasifikimit të tyre.

(i) Njohja

Shoqëria fillimisht një kreditë dhe depozitat në datën kur lindin të drejtat dhe detyrimet përkatëse. Të gjitha detyrimet dhe aktivet financiare njihen në datën e transaksionit sipas së cilit Shoqëria bëhet palë e detyrimeve kontraktore të instrumentit.

(ii) Matja e mëpasshme

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare tyre përbëhen nga paraja në arkë, llogaritë rrjedhëse në banka dhe depozitat afatshkurtra të mbajtura në banka. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Huadhenia dhe llogarite e arketueshme (Llogarite e arketueshme tregtare dhe të tjera)

Huadheniet dhe llogarite e arketueshme janë të matura me pas me koston e amortizimit të tyre me pak se cdo humbje nga demu. Llogarite e arketueshme me një kohezgjatje të shkurtër nuk zbriten.

4. Përmbledhje e politikave kryesore kontabel (vazhdim)

4.11 Instrumentat financiarë (vazhdim)

Huatë dhe llogari të tjera të pagueshme

Llogari të tjera të pagueshme maten më pas me koston e amortizuar.

Fitimet dhe humbjet njihen në fitim ose humbje kur aktivet dhe detyrimet financiare e mësipërme nuk janë njohur ose të dëmtuar, si edhe nëpërmjet procesit të amortizimit.

(iii) Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyre individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(iv) Mosnjohja

Akivet financiare nuk njihen nëse të drejtat kontraktuale të kompanisë të rrjedhjet cash nga aktivet financiare u mbaron afati ose kompania u transferon aktivet financiare në një pjesë tjetër pa rimarrë kontrollin ose thelbin e të gjitha risqeve dhe shpërblimeve të aktiveve. Detyrimet financiare nuk njihen nëse detyrimet e kompanisë të specifikuar në kontratë u mbaron afati, shlyhen ose anulohen.

(v) Kompensimi i instrumentave financiare

Aktivt financiare dhe detyrimet financiare janë kompensuar në shumën neto të raportuara në pasqyrën e pozicionit financiar dhe vetëm nëse është aktualisht e drejta ligjore e detyrueshme për kompensimin e shumave të njohura dhe nëse nuk ka qëllim për të vendosur në bazë neto ose për të realizuar aktivet dhe shlyer detyrimin njëherësh.

(vi) Vlera e drejtë

Vlera e drejte e cash-it dhe ekuivalenteve të cash-it, llogaritet e arkëtueshme tregtare dhe të tjera, llogaritet e pagueshme tregtare dhe të tjera janë përafërsisht të barabarta me vlerën e mbartur për shkak të maturisë së tyre afatshkurtër.

4.12. Kapitali, fitimet e pashpërndara / humbje të akumuluar dhe pagesa e dividendëve

Pjesa / Kapitali i regjistruar i kompanisë reflekton vlerën nominale të aksioneve të emetuara. Të ardhurat / humbjet e pashpërndara të akumuluar përfshihen në rezultatin financiar të vitit aktual dhe fitimet e akumuluar dhe humbjet nga vitet e kaluara. Detyrimi për dividendët e pagesës njihet në